

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISE PROFESIONALE.

### Neni 1, Përcaktime

**Kushtet e përgjithshme** të kontratës së sigurimit të përgjegjësive profesionale të Siguruarit, këtu e në vazhdim do të quhen Kushtet e kontratës së Sigurimit, ose shkurt "Kushtet e Sigurimit".

**Dëshmia e sigurimit**, që vërteton lidhjen e kontratës së sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet "Polica e Sigurimit".

**ALBSIG SHA** është Siguruesi i kësaj kontrate sigurimi.

**Policembajtësi ose Kontraktuesi** do të kuptohet personi që kryen veprime dhe nënshkruan kontratën e sigurimit për llogari dhe në emër të të Siguruarit/ve.

**I Siguruari** është personi fizik ose juridik interesi pasuror i të cilit mbulohet me sigurim sipas ketyre kushteve sigurimi. I siguruari dhe Policembajtësi janë i njëjti person, përveç rasteve të nënshkrimit të polices për llogari të tjerëve.

**Primi**, është shuma e parave e paguar nga i Siguruari, perkundrejt leshimit të polices së sigurimit nga Siguruesi.

**Demshperblimi**, është shuma e parave e paguar nga Siguruesi të Siguruarit në pajtim me kushtet e Sigurimit.

**Gabimi Profesional**, është gabimi i të Siguruarit që nenkupton veprim të gabuar, mosveprim ose harrese, që ndodh gjatë kryerjes së detyrave të tij profesionale të lidhura me licënsimin e tij profesional ose ushtrimin e veprimtarisë së tij të njohur të ekspertit.

**Pakujdesi e madhe**, konsiderohet mos vemendja ekstreme, ose mungesa e kujdesit dhe vemendjes që pritej nga çdo ekspert apo profesionist.

### Neni 2, Objekti i kontratës, Rreziqet e Siguruara

Objekti i kësaj kontrate është marrëdhënia juridike në të cilën Siguruesi, brenda limitit të demshperblimit dhe në përputhje me këto kushte sigurimi mbulon, kërkesat për demshperblim të klienteve që rezultojnë nga gabimet profesionale të të Siguruarit pergjate ushtrimit të profesionit të tij të regjistruar ose të licënsuar dhe për të cilat ai mbahet pergjegjes ne baze të Ligjit.

### Neni 3, Rreziqet te Perjashtuara

(1) Siguruesi nuk mbulon dhe demshperblen kërkesa për humbje dhe demtime:

- 1) që në pajtim me një kontrate ose marrëveshje të veçante kalojnë kufirin ose fushën e pergjegjesise se percaktuar në rregullimet ligjore ne fuqi mbi pergjegjesine;
- 2) që rezultojnë nga aktivitete të ndryshme të të Siguruarit të pa deklaruara në formularin e kërkesës ose polices së sigurimit, pavaresisht nese perfshihen ose jo në gamen ose kornizën e licënsës së tij;
- 3) që rezultojnë nga kontrata ku i Siguruari vepron si kontraktues, prodhues apo furnizues, pavaresisht nese lidhen me aktivitetin e tij të licënsuar ose jo;
- 4) që rezultojnë nga humbje e dëme të sende e demtime të shendetit;
- 5) që vijne si rezultat i zoterimit apo perdorimit të mjeteve motorrike tokesore, ujore apo ajrore nga ose ne emer te të Siguruarit;
- 6) për shkak të shkeljes së afateve kohore;
- 7) nese i Siguruari ose punonjësit e tij shkaktojnë gabime profesionale të qellimshme ose prej Pakujdesise së Madhe;
- 8) që shkaktohen kur i Siguruari ose personat që punojnë për të nuk janë të regjistruar ose licënsuar sipas kërkesave për ushtrimin e aktivitetit;
- 9) që shkaktohen nga shkelja e qellimshme nga i Siguruari i ligjeve ose rregullimeve të tjera ligjore, instruksioneve ose kushteve të klientit ose shkelja e qellimshme e detyrimeve të tij kontraktore;
- 10) të shaktuara me mashtrim ose veprime të tjera kriminale;
- 11) të shaktuara me shtrengim, dhune e detyrim ose gjate tentatives për kryerjen e të njejtave;
- 12) për shkak të gjobave të cilat duhet të paguhen nga klienti ose i Siguruari;
- 13) për të gjitha llojet e dëmeve që nuk kanë qellim kompensimi (si demet ndeshkuese);
- 14) për shkak të humbjes të të dhenave ose dokumenteve (të shkruara, printuara ose ruajtura elektronikisht) të besuara të Siguruarit për ruajtje;
- 15) të ardhura nga persona të siguruar me kete police kunder njeri tjetrit, ose ortaket me cilesine e Pronareve ose Punedhenesve kunder njeri tjetrit, nese pjesa ose zoterimi i tyre ne kompani kalon 25% dhe ato kanë të drejte ose mundesi të drejtojnë kompaninë në baze të ligjit ose statutit (Ortakët në maxhorance), ose kërkesat për humbje e dëme nga anetaret e familjes të të Siguruarit, bile edhe nese ato janë të punësuar prej tij, si edhe anetareve të familjes të ortakeve maxhoritare, që janë punësuar në kompaninë pergjegjesia profesionale e të ciles është siguruar;
- 16) që rrjedhin prej mos plotësimi të detyrimeve kontraktore me klientin;
- 17) që rrjedhin nga tejkalimi i kostove të vlerësuar ose kursit të shkëmbimit;
- 18) që lidhen me pagesën e shërbimit;
- 19) që rrjedhin në shtesë të humbjeve të pritshme të areyeshme në kornizën ose këndveshtrimin e shërbimit të kryer ose humbjet indirekte;
- 20) që nuk kanë natyrë demi financiar (si p.sh. cenim ose njolllosje e reputacionit etj. të kesaj natyre);
- 21) që rrjedhin nga moslikuiditeti ose falimentimi i të Siguruarit;

22) Që rrjedhin nga Zjarri, Rrufeja, Eksplozimi i eneve nën presion, nga Fatkeqesite natyrore, nga Rrezatimi ose ndotja jonizuese, Radioaktiviteti prej karburanteve berthamore apo rrjedhjeve berthamore;

23) si pasoje e ngjarjeve të jashtë zakonshme si lufta, nderhyrja e forcave të huaja ushtarake pavaresisht nese lufta është shpallur ose jo, lufta civile, revolucioni, aktet terroriste, aktet e sabotazhit dhe aktet e vandalizmit.

### Neni 4, Shuma e Siguruar

(1) Mbulimi i Siguruesit për çdo një ngjarje të veçantë ose individuale sigurimi percaktohet nga shuma e siguruar e rene dakord dhe pranuar nga palet.

(2) Siguruesi paguan për të gjitha ngjarjet e sigurimit që sjellin humbje e dëme brenda një viti (agregati vjetor) një shumë demshperblimi maksimalisht sa dyfishi i shumës së sigurimit të rene dakord dhe pranuar për një ngjarje sigurimi, po të moj jete rene dakord dhe pranuar një shumë tjetër, që shenohet në policen e sigurimit.

(3) Në rast se brenda periudhës vjetore të sigurimit Siguruesi paguan shumën totale vjetore (agregatin vjetor), Polica e sigurimit mund të mbetet në fuqi dhe vijon mbulimin vetëm nëse arrihet marrëveshje e veçantë për vazhdimin e mbulimit. Në këtë rast një prim shtesë percaktohet veçanerisht.

### Neni 5, Ngjarja ose Rasti i Sigurimit

(1) Siguruesi mbulon kërkesat për demshperblim të cilat fillimisht i njoftohen të Siguruarit pergjate periudhës së sigurimit ose periudhës së zgjeruar të mbulimit (nese aplikohet dhe është shënuar në police një tille) dhe i raportohen Siguruesit sa më shpejt që të jete e mundur, por jo më vonë se 30 dite nga dita që i njëjti njoftim i është dhënë të Siguruarit, me kusht që e tille kërkesë për demshperblim të jete shkaktuar nga gabime profesionale (ngjarje sigurimi) të ndodhura pergjate periudhës së mbulimit dhe humbja të mos mbulohet nga cdo police tjetër sigurimi e të Siguruarit.

(2) Kërkesë për Demshperblim do të thotë që:

- 1) një procedure gjyqesore, administrative ose arbitrazhi të kete filluar kunder të Siguruarit në të cilën Ai mund të jete subjekt i një gjykimi të detyrueshem për pergjegjesine për dëme;
- 2) një njoftim me shkrim nga klienti për të Siguruarin ose Siguruesin qellimi i të cilit është të mbaje ose percaktojë pergjegjes të Siguruarin për humbje të shkaktuar nga një gabimi profesional pergjate ushtrimit të aktivitetit të regjistruar apo licënsuar.
- 3) Nëse disa kërkesa për demshperblim vijne ose rezultojnë nga i njëjti veprim, harrese ose gabim i të Siguruarit, konsiderohet që një ngjarje sigurimi ndodhi, pavaresisht numrit të kërkesave apo kërkesave për demshperblim. Kërkesa e parë e njohur konsiderohet koha kur ndodhi ngjarja e sigurimit. Konsiderohet që ndodhi një ngjarje sigurimi, bile edhe nese kërkesat për demshperblim rezultojnë nga disa gabime profesionale të cilat fillojnë në të njëjtat rrethana dhe janë të lidhura ligjerisht, ekonomikisht ose në kohe.
- 4) Nëse gabimi profesional është harrese, konsiderohet që ajo të kete ndodhur në ditën e fundit në të cilën veprimi (që u harrua pa u kryer) duhej të kryhej në menyre që humbja të parandalohej.

### Neni 6, Periudha e sigurimit ose mbulimit të Pergjegjesise, Rinovimi, Territori i vlefshmerise.

(1) Pergjegjesia e sigurimit në baze të kontratës së sigurimit fillon në mesnatën e datës së shënuar në police si date e fillimit të mbulimit, nese primi i sigurimit është paguar në llogarinë e Siguruesit deri në kete date. Përndryshe pergjegjesia e Siguruesit shtyhet deri në mesnatën e datës së pagesës së primit të sigurimit, nese nuk është rene dakord ndryshe. Si rregull policat e sigurimit leshohet me afat 1 vjeçar.

(2) Pergjegjesia e Siguruesit mbaron në mesnatën e datës së shënuar në police si date e skadimit të kontratës së sigurimit.

(3) Nëse në policën e sigurimit shenohet vetëm data e fillimit të polices, polica e sigurimit si dhe pergjegjesia e Siguruesit për mbulimin me sigurim dhe po ashtu pergjegjesia e të Siguruarit për pagesën e primit rinovohet nga një vit në tjetrin, duke filluar nga e njëjta date në vitin pasardhës, derisa njëra nga palet heq dorë nga kontrata e sigurimit me njoftim me shkrim palet tjetër, të paktën 3 muaj përpara mbarimit të mbarimit të periudhës së sigurimit në vitin aktual ose në vijim. Nëse polica lidhet me afat me shumë se 3 vjet secila pale mund të heq dorë nga kontrata me njoftim me shkrim jo më heret se 6 muaj, përpara skadimit të polices të vitit aktual ose në vijim.

(4) Territori i vlefshmerisë së kësaj kontrate është territori i Republikës së Shqipërisë, nese nuk është rene dakord ndryshe nga palet e interesuara dhe shënuar në police.

### Neni 7, Demshperblimi, Pjesa e Zbritshme, Franshiza.

(1) Demshperblimi është humbja e percaktuar në pajtim me parashikimet e ketyre kushteve të sigurimit dhe e kufizuar në shumën e sigurimit të rene dakord e shënuar në police.

(2) Vlera e demshperblimit zvoglohet me pjesën që mbart vete i Siguruari, të shprehur me Pjesën e zbritshme në përqindje dhe/ose Franshizën në vlerë nominale mbi çdo një dëm ose seri dëmsh të ndodhura nga një rast ose ngjarje e vetme sigurimi. Pjesa e zbritshme dhe/ose Franshiza shënohen në policën e sigurimit.

Siguruesi nuk do të paguajë dëme që vlerësohen më pak se vlera e Franshizës së percaktuar në policë. Në të gjitha rastet e tjera, ku vlera e dëmit kalon vlerën e Franshizës aplikohet Pjesa e Zbritshme në %, mbi

shumen e dëmshpërblimit të përlogaritur për t'ju paguar të Siguararit ose Përfituesit.

- (3) Nese i Siguarari ka ose disponon police sigurimi pergjegjesie profesionale kolektive si dhe nje sigurim pergjegjesie profesionale individuale shtese, kur ngjarja e sigurimit ndodh demshperblimi paguhet ne baze te police se sigurimit te pergjegjesise profesionale kolektive.  
Demshperblimi ne baze te kontrates se sigurimit te pergjegjesise individuale paguhet vetem kur mbulimi i pergjegjesise sipas sigurimit te pergjegjesise profesionale kolektive nuk eshte i mjaftueshem referuar pjeses se pa mbuluar te humbjes.
- (4) Nese i Siguarari kryen nje sherbim tek nje klient se bashku me persona ose profesioniste te tjere (bashkepunim me pale ose Entite te ndryshme per kryerje punimesh), demshperblimi zvoglohet sa raporti i shumes se siguruar te te Siguararit ne kete police jep me totalin e shumave te siguruar te percaktuara per te njejtin rriske ose objekt sigurimi te te Siguararit ketu plus ato (shumat e siguruar) te bashkepunuesve te tjere.

#### **Neni 8, Pershkrimi i Rrisikut ose Aktivitetit qe sigurohet (Objekti i Sigurimit).**

- (1) Ne momentin e lidhjes se kontrates se sigurimit i Siguarari duhet ti zbuloje Siguruesit te gjitha rrethanat e faktet e rendesishme per pranimin ose marrjen ne sigurim te rrisikut, per te cilat ai ka dijeni ose duhej te kishte dijeni.
- (2) I Siguarari duhet te njoftoje menjehere Siguruesin per cdo ndryshim te rrethanave e fakteve te cilat do te vleresoheshin te rendesishme per vleresimin e rrisikut, pergjate periudhe se sigurimit.
- (3) Nese eshte e nevojshme i Siguarari duhet ti mundesoje Siguruesit te inspektoje e kontrolloje rrisikun.

#### **Neni 9, Përlogaritja e Primit të Sigurimit. Pasojat e mospagimit të tij, Kthimi i Primit të Sigurimit.**

- (1) Përlogaritja e primit të sigurimit bëhet sipas metodave të tarifimit të përcaktuara nga Siguruesi, si edhe në funksion të informacionit dhe të dhënave të deklaruara nga i Siguarari.
- (2) Primi i sigurimit paguhet njëherësh ose me këste ne baze te fatures se shitjes ose çdo dokumenti tjetër pagese leshuar nga Siguruesi.
- (3) Pergjegjesia e Siguruesit te paguaje demshperblim per humbjen ose demin perfundon ne rastin e mospagimit te primit të sigurimit, këstit te pare ose te radhes brenda afatit prej 15 ditësh duke filluar nga data e maturimit të pagesës së tij shënuar në policën e sigurimit, si edhe sipas parashikimeve te Nenit 6, pg.3 – per rinovimin me siper, afat i cili skadon në orën 24.00 të ditës së 15-të. Vertetimi i faktit te mospageses se primit si parishikuar ketu, zgjidh automatikisht Kontratën e Sigurimit, pa patur nevojje per njoftim tjetër te veçante nga Siguruesi.
- (4) I Siguarari është përgjegjës për pagesën e primit, këstit edhe në ato raste kur ai pretendon, që Siguruesi nuk e ka njoftuar për datat e maturimit.
- (5) Në rast të ndërprerjes së njëanshme të Kontratës së Sigurimit nga palët, primi i paguar i kthehet të Siguararit në perpjestim me kohën që mbetet deri në mbarim të afatit ose periudhes se mbulimit të kontratës se sigurimit, duke zbritur shpenzimet administrative përkatëse.

Kthimi i primit ndalohej në këto raste:

- 1) kur i Siguarari ka përfutur ose pritë te perfitoje demshperblim nga Siguruesi, pavaresisht vleres se tij;
- 2) kur kerkesa per kthim primi behet me vone se dy muaj nga perfundimi i afatit te vlefshmerise së kontratës të përcaktuar në policë.

#### **Neni 10, Detyrimet e Paleve me ndodhjen e nje Rasti Sigurimi**

##### **A. Detyrimet e te Siguararit**

- (1) Të marrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet e mundshme për minimizimin e pasojave të demit/ve te shkaktuara nga ngjarja e sigurimit;
- (2) Të njoftojë menjëherë Siguruesin per ndodhjen e ngjarjes se sigurimit. Nese nje hetim per kundravajtje penale ose civile fillon ose ka shenja (indicie) qe do te filloje kunder te Siguararit ose personave per te cilet ai (i Siguarari) eshte pergjegjes njofton menjehere Siguruesin pavaresisht se kishte njoftuar me pare per ndodhjen e te njejtës ngjarje sigurimi;
- (3) Nese i Siguarari merr nje kerkese per demshperblim nga te tretet ose veprime lidhur me demet kane filluar kunder tij, i Siguarari duhet te njoftoje menjehere Siguruesin dhe ti paraqese atij te gjitha dokumentet qe lidhen me kerkesen/at per demshperblim;
- (4) Të lejojë dhe ti jape fuqi ligjore perfaqesimi Siguruesit apo juristit te caktuar prej tij qe te drejtoje veprimet ligjore qe lidhen me ngjarjen e sigurimit, pasojat dhe zgjidhjen e saj. Nese i Siguarari nuk lejon Siguruesin te drejtoje zgjidhjen e kerkeses/ave per demshperblim, Siguruesi nuk eshte pergjegjes te paguaje kostot ekstra te kerkeses per demshperblim, interesat apo shpenzimet ligjore e te tjera te lidhura me te.
- (5) Në pajtim me detyrimin e percaktuar ne paragrafin (4) me siper, I Siguarari nuk refuzon dhe per me teper nuk mundet te pranoje bazuar mbi gjykimin, vleresimin dhe vullnetin e vet, asnje kerkese per demshperblim te ardhur nga te tretet.

##### **B. Detyrimet e Siguruesit**

- (1) Ti dorezoje te Policembajtesit ose te Siguararit kushtet e vlefshme te sigurimit qe perbejne ose konsiderohen pjese e kontrates se sigurimit.
- (2) Të kontrolloje kerkesat per demshperblim si lidhur me percaktimin e pergjegjesise ashtu edhe vleren e demit ose humbjes, si dhe te siguroje mbrojtjen e te Siguararit nga kerkesat e pajustificuara ose te egzgjeruara nga te tretet.
- (3) Të mbuloje shpenzimet dhe kostot ligjore te te Siguararit te vendosura ne favor te te treteve, vetem nese Siguruesi ose personi i autorizuar prej tij drejton veprimet e nevojshme ligjore prej momenteve te fillimit te zgjidhjes ligjore te kerkeses per demshperblim. Cilado qofte vlera e ketyre sherbimeve demshperblimi perfundimtar per deme e sende se bashku me shpenzimet e kostot ligjore nuk kalojne shumen e sigurimit te percaktuar ne police. Po keshtu Siguruesi mbulon edhe shpenzimet e kostot ligjore te ceshtjes penale te ngritur kunder te Siguararit, kur merr persiper shprehimisht te beje avokatin mbrojtjes te te Siguararit. Edhe ne kete rast vlera totale e demshperblimit perfshi kostot ligjore te ceshtjes penale nuk e kalon shumen e sigurimit te percaktuar ne police.
- (4) T'i japë të Siguararit rekomandimet e nevojshme në bazë të të gjitha inspektiveve, ekspertizave dhe veprimeve të nevojshme për mbrojtjen e interesit të tij.

Nëse i Siguarari refuzon të pranojë rekomandimet e Siguruesit:

- 4.1** siguruesi nuk ka detyrim të mëtejshëm për të mbrojtur interesat e tij; dhe
  - 4.2** përgjegjësia e Siguruesit për dëme, në lidhje me limitin e dëmshpërblimit, nuk do të tejkalojë ose do të kufizohet ne vlerën e dëmshpërblimit të parashikuar nga ai (Siguruesi).
- (5) Te kompensojë të Siguararin në përputhje me këto kushte sigurimi jo më vonë se 30 ditë nga dorëzimi i vendimit perfundimtar të formës së prerë të Gjykatës për ngarkimin me përgjegjësi të të Siguararit, minus pjesën e zbritshme të shenuar në policën e sigurimit.

#### **Neni 11, Proçedura e zgjidhjes se konflikteve me Eksperte ose Ente te njohura Arbitrazhi**

- (1) Secila prej paleve kontraktuese mundet te kerkoje qe mosmarreshjet lidhur me disa fakte te zgjidhen nga eksperte te fushes.
- (2) Secila prej paleve cakton dhe emerone per mbrojtjen e interesave te veta, nje ekspert ndermjet atyre qe nuk kane lidhje ose marredhenie pune me palet. Ekspertet e emeruar perpara fillimit te punes emerone nje ekspert te trete i cili shpreh opinionin e vet vetem ne ato raste kur perfundimet e eksperteve te paleve ndryshojne nga njeri tjetri dhe kufizohet vetem per aq sa ato ndryshojne.
- (3) Rezultatet ose perfundimet e eksperteve jane detyruese per palet.
- (4) Secila pale mban vete shpenzimet e eksperteve te emeruar nga ato vete dhe ndajne nga 50 % shpenzimet e ekspertit te trete, te emeruar bashkerisht.

#### **Neni 12, Përfundimi dhe zgjidhja e kontratës**

Kjo kontratë sigurimi:

- 1) përfundon kur ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe Siguruesi ka dëmshpërblyer të Siguararin në limitin agregat të përcaktuar në policën e sigurimit;
- 2) zgjidhet menjëherë kur primi, kësti i radhes ose primi i rinovimit nuk janë paguar brenda 15 ditëve nga afati i maturimit të pagesës;
- 3) zgjidhet menjëherë kur Siguruesi njihet me të dhëna ose fakte të reja, që më parë janë fshehur ose deklaruar në mënyrë të rreme qëllimisht nga i Siguarari.
- 4) kontrata nje vjeçare përfundon kur njëra nga palët shprehet në mënyrë të njëanshme për ndërprerjen e saj me njoftim paraprak 30 ditor. Kontratat e sigurimit pa afat skadence ose me afat mbi 3 vjet përfundon me njeftim me shkrim pales tjetër, sipas afateve te parashikuara ne Nenin 6, paragrafi 3. Njoftimi do të quhet i kryer që në ditën e dërgesës së tij me postë.

#### **Neni 13, Menyra e komunikimit, Ndryshimi i adreses**

- (1) Te gjitha marreshjet mbi permbajtjen e kontrates se sigurimit, njoftimet e shpalljet qe duhet te paraqiten ose te jepen ne pajtim me parashikimet e Kontrates se sigurimit behen me shkrim.
- (2) Njoftimet e shpalljet konsiderohen se jane kryer ne kohe nese dergohen me leter te rregjistruar brenda afatit te parashikuar.
- (3) I Siguarari duhet te njoftoje Siguruesin per ndryshimin e emrit apo adresen e selise se kompanise. Nese i Siguarari ndryshon emrin apo adresen e kompanise dhe nuk njofton Siguruesin, eshte e mjaftueshme qe Siguruesi te dergoje njoftimet ne emrin dhe adresen e rezidences se fundit te tij.

#### **Neni 14, Ligji i aplikueshem, Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve**

- (1) Ligji i aplikueshem ne marredheniet ndermjet Siguruesit dhe te Siguararit, kur nuk zgjidhen nga percaktimet e ketyre kushteve e termave te kesaj kontrate sigurimi, eshte Kodit Civil i Republikes se Shqiperise, percaktimet dhe parashikimet e Pjeses se IV<sup>tert</sup> - Detyrimet dhe Kreu XXIII - Sigurimet.
- (2) Në rastet kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente është gjykata e vendit ku është lëshuar policia e sigurimit.